



PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëri e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë botim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

COPYRIGHT DHE AUTORËSIA:

Copyright © 2021 nga KIPRED.

Autor: Lulzim Peci

Kontributorë: Mentor Agani dhe Diedon Nixha

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

Email: info@kipred.org



Raport i Politikave

Kundërvënia Operacioneve Malinje Informative Ruse:

**Kapacitetet dhe Koordinimi Institucional
Qeveritar i Kosovës**

MARS 2021



Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Përmbledhje Ekzekutive | 3 |
| Hyrje | 4 |
| Operacionet Malinje Informative Ruse: Reflektime të Institucioneve të Politikës së Jashtme të Kosovës | 8 |
| Kapacitetet e Institucioneve të Politikës së Jashtme të Qeverisë së Kosovës | 12 |
| Kapacitetet e Institucioneve të tjera Relevante Qeveritare | 16 |
| Kundërvënia Operacioneve Malinje Informative Ruse: Rruga Përpara | 19 |
| Rekomandimet | 23 |

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport i politikave i shqyrton dhe i vlerëson kapacitetet institucionale dhe koordinimin ndër-institucional të institucioneve të Qeverisë së Kosovës për t'i treguar dhe për t'iu kundërvënë operacioneve malinje informative ruse kundër Kosovës.

Gjetjet e hulumtimit japin dëshmi të mjaftueshme që institucionet e politikës së jashtme të Kosovës, domethënë Zyra e Presidentit (ZP), Zyra e Kryeministrit (ZKM), dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), as nuk i kanë kapacitetet themelore, dhe as nuk janë të koordinuara lidhur me kundërvënien ndaj përpjekjeve malinje ruse kundër Kosovës.

Nga ana tjetër, institucionet e tjera relevante qeveritare, sikurse Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë kapacitete të mjaftueshme që institucioneve të politikës së jashtme të Kosovës t'u japin informatat e nevojshme për t'iu kundërvënë operacioneve malinje informative dhe atyre diplomatike ruse, e që përhapen nga mediat e kontrolluara nga Moska.

Në kuadër të këtij sfondi hulumtues, ky raport i politikave e rekomandon themelimin e Task Forcës për Komunikim Strategjik për të ju kundërvënë operacioneve malinje informative dhe diplomatike ruse dhe të shteteve të tjera kundër Kosovës. Për më tepër, ky raport i politikave po ashtu i rekomandon disa masa për bërjen e politikave. Kjo e përfshin përpilimin e strategjisë së re të politikës së jashtme të Kosovës që duhet ta merr parasysh mjedisin bashkëkohor politik ndërkombëtar, dhe posaçërisht politikën e jashtme ruse, dhe Planin e Veprimit për t'iu kundërvënë luftës diplomatike ruse dhe operacioneve të saj malinje informative kundër Kosovës.

Së fundi, ky raport i rekomandon disa masa për ndërtimin e kapaciteteve për rritjen e aftësive të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, dhe të institucioneve të tjera relevante qeveritare, si dhe të mediave dhe të shoqërisë civile, lidhur me strategjitë dhe taktikat ruse të dezinformimit, për kundërvënien dezinformimit, dhe për rritjen e njohurive të përgjithshme për historinë politike, ushtarake dhe diplomatike të Rusisë, dhe për ekonominë e saj bashkëkohore, për të qenë në gjendje për t'u marrë me këtë kërcënim në mënyrë profesionale.

Hyrje

Operacionet malinje informative ruse ndaj Kosovës janë sistematike, të qëndrueshme dhe këmbëngulëse në afat të gjatë. Në rrjedhën e 20 viteve të fundit, nga të gjitha postimet e bëra në ueb-sajtet zyrtare të institucioneve dhe përfaqësimeve qeveritare ruse, është e pamundur të gjendet madje edhe një pohim i vetëm pozitiv për Kosovën.

Posti i parë lidhur me Kosovën që mund të gjendet në ueb-sajtin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) të Federatës Ruse, e ka datën 19 shtator 2001, një javë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara. MPJ ruse e transmeton deklaratën e “Patriarkut më të Shenjtë të Moskës dhe të tërë Rruisë, Alexy II dhe të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Ruse, për Veprat e Terrorizmit në Amerikë,” në të cilën, ndër të tjera, ai i ndërlidh sulmet e tmerrshme terroriste të Al-Qaidës në Shtetet e Bashkuara me shqiptarët në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Kjo deklaratë thekson se “në Kosovë e Metohi, vendet e shenjta ortodokse janë ende duke u shkatërruar, dhe popullata civile është duke iu nënshtruar terrorit.”¹ Që atëherë e deri në fund të shkurtit 2021, në ueb-sajtin e Ministrisë së Jashtme Ruse janë postuar 826 postime të ndërlidhura drejtpërdrejtë apo tërthorazi me Kosovën, 35 nga të cilat në vitin 2020, dhe 48 në 2019.² Nga ana tjetër, posti i parë i postuar gjatë periudhës nga viti 2000 deri në shkurt 2021 në ueb-sajtin e Kremlinit, që kishte të bënte drejtpërdrejtë apo tërthorazi me Kosovën, daton më 31 gusht 2000.³

Këtyre operacioneve malinje informative të Moskës ndaj Kosovës nga këndvështrimi i diplomacisë publike ju bashkangjiten edhe deklaratat dhe postimet e misioneve ruse në organizatat kyçe ndërkombëtare, dhe atë kryesisht në Misionin e Përhershëm Rus në Kombet e

¹ Deklaratë nga “Patriarku Më i Shenjtë i Moskës dhe i tërë Rruisë, Alexy II, dhe i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Ruse për Veprat e Terrorizmit në Amerikë,” 19 shtator 2001,

https://www.mid.ru/en/web/guest/foreign_policy/international_safety/crime/-/asset_publisher/3F5IZsLVsX4R/content/id/572828

²

https://www.mid.ru/en/search?p_p_id=3&p_p_lifecycle=0&p_p_state=maximized&_3_struts_action=%2Fsearch%2Fsearch

³ Kremlini, “Vlladimir Putini e nënshkroi rezolutën që e zgjat afatin e shërbimit të Ministrisë së Brendshme Ruse dhe të personelit të Shërbimit Mbrojtës të Kufijve Federalë si pjesë e forcës ndërkombëtare policore në Kosovë, Republika Federale e Jugosllavisë,” 31 gusht 2000, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/39077>

Bashkuara (KB),⁴ në Misionin e Përherëshëm Rus në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE),⁵ dhe në përfaqësimin e Përherëshëm Rus në Këshillin e Evropës (KE),⁶ si dhe nga ato të Ambasadës Ruse në Beograd.⁷

Nuk ka dyshim që konteksti i luftës dezinformuese kundër Kosovës përforcohet po ashtu edhe nga ndërvarësia e Moskës dhe Beogradit, në ndjekjen e interesave të politikave të tyre të jashtme ndaj Prishtinës, Brukselit dhe Uashingtonit. Po aq sa Serbia ka nevojë që Rusia t'i përkrah synimet e saj ndaj Kosovës, po aq edhe Rusia ka nevojë që Serbia t'i ndjek interesat e politikës së saj të jashtme, duke futur jostabilitet në oborrin e Perëndimit, dhe duke u grindur me Perëndimin në Ballkan.⁸ Sa i përket kësaj, një momentu kyç i këtyre përpjekjeve kundër Kosovës është shënuar nga takimi i Këshillit të Sigurisë së Ruisë që ishte mbledhur nga Presidenti Putin më 18 janar 2019, një ditë pas vizitës së tij në Beograd, e cila ishte përqendruar në tërësi në Kosovën.⁹

Ky takim e dha një sinjal të qartë se Kosova është shumë lart në axhendën e Kremlinit dhe se ajo ishte një çështje e të tërë strukturës së jashtme dhe të sigurisë të Ruisë. Pas këtij takimi, operacionet malinje informative ruse u intensifikuan me narrativa më të shënjestëruara dhe më të strukturuar.¹⁰

Për më tepër, të dhënat e përfuara nga monitorimi i mediave që KIPRED-i e ka bërë nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020, tregon se botimet e përzgjedhura mediale të kontrolluara nga qeveria ruse kanë botuar 1839 lajme që kanë patur të bëjnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi me Kosovën. Domethënë, Sputnik–Serbia ka botuar 1592, Sputnik International 41, Russia Today 59, Russia

⁴ Misioni i Përherëshëm Rus në Kombet e Bashkuara deri më tash i ka bërë 192 postime që kanë patur të bëjnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi me Kosovën, <https://russiaun.ru/site/search/lang/ru?search=Kosovo>

⁵ Misioni i Përherëshëm i Federatës Ruse në OSBE, <https://osce.mid.ru/web/osce-en/permanent-representative>

⁶ Përfaqësimi i Përherëshëm i Federatës Ruse në Këshillin e Evropës, https://coe.mid.ru/en_GB

⁷ Ambasada e Federatës Ruse në Serbi, <http://www.ambasadarusije.rs/>, <https://serbia.mid.ru/ru/>

⁸ Lulzim Peci, Special Policy Brief, Russia's Information Warfare Against Kosovo: Political Background and Manifestation [Përmbledhje Speciale e Politikave, Lufta Informative e Ruisë Kundër Kosovës: Prapavija dhe Manifestimet Politike], KIPRED, tetor 2020, fq. 3, http://www.kipred.org/repository/docs/Russia_-_Kosovo_Political_Background_-_Eng_-_Fin_616233.pdf

⁹ Kremlin, Takimi me anëtarët e përherëshëm të Këshillit të Sigurisë, 18 janar 2019, <http://en.kremlin.ru/catalog/persons/511/events/59693>

¹⁰ Lulzim Peci, Special Policy Brief, Russia's Information Warfare Against Kosovo: Political Background and Manifestation [Përmbledhje Speciale e Politikave, Lufta Informative e Ruisë Kundër Kosovës: Prapavija dhe Manifestimet Politike], KIPRED, tetor 2020, fq.20. http://www.kipred.org/repository/docs/Russia_-_Kosovo_Political_Background_-_Eng_-_Fin_616233.pdf

Insider 13, Meduza 1, TASS-i 40, Moscow Times 8, Newsfronti 55, UNZ-i 15, dhe The Duran 15 lajme.¹¹

Një analizë e kujdesshme e dëshmive të mbledhura për dezinformatat dhe propagandën kundër Kosovës nga burimet zyrtare ruse (Kremlini, Ministria e Punëve të Jashtme, Misioni i Përherëshëm Rus në Kombet e Bashkuara, dhe Ambasada Ruse në Beograd), të përhapura nga mediat e kontrolluara nga Moska, tregon se ato janë të grumbulluara rreth narrativave vijuese të shënjestruara në rrënimin e themeleve të shtetësisë së Kosovës:¹²

- Në paraqitjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës si të paligjshme dhe si shkelje të së drejtës ndërkombëtare, dhe në krahasimin e tyre me aneksimin rus të Krimesë.
- Në paraqitjen e Kosovës si një kuazi-shtet, që është kriminal dhe që duhet përjashtuar, i cili ushtron dhunë kundër komunitetit lokal serb dhe Kishës Ortodokse Serbe, dhe është strehë e ekstremizmit islamik, dhe i cili po ashtu nuk i respekton marrëveshjet e veta me Brukselin.
- Në manipulimin dhe përpjekjet për t'i ndryshuar narrativat për luftën e Kosovës, duke i mohuar krimet e luftës të kryera nga Serbia në Kosovë, duke e paraqitur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si një organizatë terroriste, dhe Kosovën si një krijesë shtetërore që është krijuar përmes "gjenocidit" të përkrahur nga vendet Perëndimore kundër popullatës serbe, duke e rritur numrin e viktimave serbe gjatë luftës, duke i ulur përpjekjet ndërkombëtare dhe vendëse për t'u marrë me krimet e luftës në Kosovë, dhe duke e vënë në ballë çështjen e Zyrave Speciale dhe "trafikimin e hamendësuar të organeve."

¹¹ KIPRED, Njoftim për shtyp: Fushata Dezinformuese e Mediave ruse dhe serbe ndaj Kosovës: Çfare mësimesh mund të nxirren nga monitorimi i mediave gjatë vitit 2020, 25 shkurt, 2021, <http://www.kipred.org/sq/lajmet/Fushata-Dezinformuese-e-mediave-ruse-dhe-serbe-kunder-Kosoves-Cfare-mesimesh-mund-te-nxirren-nga-monitorimi-i-mediave-gjate-vitit-2020-434>

¹² Për hollësi të mëtejshme shih: Lulzim Peci, Special Policy Brief, Russia's Information Warfare Towards Kosovo: Political Background and Manifestation [Përmbledhje Speciale e Politikave, Lufta Informativ e Ruisë Kundër Kosovës: Prapavija dhe Manifestimet Politike], KIPRED, tetor 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/Russia_-_Kosovo_Political_Background_-_Eng_-_Fin_616233.pdf dhe KIPRED, Njoftim për shtyp: Fushata Dezinformuese e Mediave ruse dhe serbe ndaj Kosovës: Çfare mësimesh mund të nxirren nga monitorimi i mediave gjatë vitit 2020, 25 shkurt, 2021, <http://www.kipred.org/sq/lajmet/Fushata-Dezinformuese-e-mediave-ruse-dhe-serbe-kunder-Kosoves-Cfare-mesimesh-mund-te-nxirren-nga-monitorimi-i-mediave-gjate-vitit-2020-434>

- Në shkatërrimin e themeleve të rolit të Perëndimit në shtet-ndërtimin e Kosovës, dhe posaçërisht për sundimin e ligjit dhe për drejtësinë tranzicionale, si dhe për aftësimin dhe pajisjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe në akuzimin e SHBA-ve për “fshehtësinë” e bazës ushtarake të Bondsteelit e cila funksionon nën mandatin e Forcës së Kosovës (KFOR) të udhëhequr nga NATO-ja.

Përgjigjet e institucioneve të politikës së jashtme të Kosovës ndaj operacioneve informative dhe diplomatike malinje kundër Kosovës, në rastin më të mirë ishin tejet të rralla dhe në baza ad-hoc. Një shikim i kujdesshëm i ueb-sajteve të Presidentit, Qeverisë dhe të Ministrisë së Jashtme të Kosovës tregon se ka fare pak përgjigje publike ndaj përpjekjeve ruse kundër Kosovës.

Në këtë sfond, përqendrimi primar i këtij raporti të politikave është t’i shqyrtojë dhe vlerësojë kapacitetet institucionale dhe koordinimin ndër-institucional të Qeverisë së Kosovës për t’iu kundërvënë operacioneve malinje diplomatike dhe informative ruse ndaj Kosovës. Lidhur me këtë, hulumtimi do të përqendrohet në Zyren e Presidentit, Zyren e Kryeministrit, si dhe në ministritë qeveritare dhe institucionet e tjera, mandatet e të cilave i mbulojnë çështjet që janë në shënjestër të narrativave dezinformuese ruse kundër Kosovës.

Operacionet Malinje Informative Ruse:

Refleksionet e Institucioneve të Politikës së Jashtme të Kosovës

Sipas zyrtarëve të intervistuar të lartë të kabineteve të Kryeministrit të Kosovës dhe të ish-Presidentit, si dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës së Kosovës, janë disa forma në të cilat vendi ndikohet nga operacionet informative malinje ruse.

Lidhur me këtë, Zëvendës Ministresha për Punë të Jashtme e Kosovës, Teuta Sahatqija, vëren se Rusia ka vepruar në forma të ndryshme në rajon në disa dekadat e fundit. Sipas saj, ndikimi rus në rajon është më i lartë se që është në Kosovë, duke pasur parasysh praninë e sllavëve dhe të Kishës Ortodokse, nga njëra anë, si dhe ndikimin ekonomik dhe ushtarak, nga tjetra. Ajo argumenton se përparësia e Kosovës është në disponimin anti-rus të shumicës së popullatës së saj, ndërkohë që edhe niveli i ndikimit ekonomik dhe ushtarak është i papërfillshëm krahasuar me vendet përreth. Në këtë mënyrë, ajo thekson se zhvillimi i teknologjisë informative i ka “pasuruar” veprimtaritë malinje të Moskës në Kosovë, dhe i ka dhënë asaj një vegël tjetër për ta ndjekur ndikimin e vet.

Për më tepër, Zëvendës Ministresha e Jashtme Sahatqija argumenton se në krahasim me vendet si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ku Rusia, pos luftës informative, ka zbatuar edhe operacione të fshehta, përfshirë edhe përpjekjen për grushtshtet në Podgoricë në vitin 2016, apo atë për destabilizimin e situatës pas zgjedhjeve të përgjithshme në Shkup, në rastin e Kosovës, operacionet malinje të Moskës janë kryesisht të kufizuara në “hapësirën kibernetike” dhe në diplomaci. Në kuadër të këtij sfondi, ajo vëren se ndikimi më i lartë i Ruisë është në skenën ndërkombëtare, posaçërisht lidhur me fushatën për çnjohjen e Kosovës dhe kundër anëtarësisë së saj në organizatat ndërkombëtare, e cila bëhet në koordinim me Serbinë, si dhe në diskursin shumë të vrazhdë dhe narrativat dezinformuese të përdorura, posaçërisht në takimet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën.¹³

¹³ Intervistë personale me ambasadorën Teuta Sahatqija, Zëvendës Ministre e Jashtme e Kosovës, 28 shkurt 2021.

Një anëtar i lartë i Zyres së Kryeministrit vëren se është evidente që angazhimi rus/serb në Kosovë është sistematik, profesional, afatgjatë, dhe kundër përfshirjes së Kosovës në strukturat Euro-Atlantike, dhe posaçërisht në NATO. Për më tepër, ai argumenton se lidhjet afatgjata të Rosisë në rajon nuk janë thyer kurrë, dhe që përpjekjet destabilizuese të Moskës në rajon nuk mund të shpjegohen si rastësi, por më parë si një zbatim i një politike të paramenduar.¹⁴

Nga ana tjetër, këshilltari politik i ish-Presidentit Thaçi, Ardian Arifaj, argumenton se edhe pse shumë çka nuk dihet në opinionin publik rreth operacioneve malinje ruse kundër Kosovës, ato paraqiten në disa forma. Rusia vepron butësisht, kryesisht përmes shpërhapjes së dezinformatave përmes mediave të kontrolluara nga strukturat e Kremlinit. Në arenën ndërkombëtare, Rusia është duke përhapur narrativa që synojnë ta kontestojnë shtetësinë dhe sovranitetin e Kosovës, rolin e Uashingtonit dhe të Brukselit në shtet-ndërtimin e saj, dhe që ta dobësojnë autoritetin e tyre, ndërsa, brenda vendit, ajo synon të shkaktojë pasiguri për pozitën e Kosovës në shkallën ndërkombëtare.¹⁵

Për më tepër, ai argumenton se marrja me “luftën hibride” të Rosisë duket se nuk është kuptuar sa duhet nga institucionet e Kosovës dhe se thellësia e këtij rreziku është nënvlerësuar. Kosova duhet t’i përgjigjet kësaj “luftë” vetë. Një shikim i shkurtër në mediat rajonale dhe evropiane tregon se sa prapa Kosova është në përballjen me fushatën e Rosisë dhe të Serbisë. Ai po ashtu pohon se klasa politike e Kosovës duhet ta kuptojë se nga fushata kundër Kosovës që vjen nga Moska, çdokush në Kosovë është humbës, dhe se nuk ka fare fitues, për shkak të faktit se është duke u shkelur shtetësia, dhe se e drejta e pavarësisë së Kosovës është duke u vënë në pyetje nga Rusia, gjë kjo që e paraqet njërin nga rreziqet kryesore për Kosovën.¹⁶

Nga ana tjetër, përgjigjet e diplomacisë publike të Kosovës ndaj këtyre operacioneve malinje informative ruse kanë qenë tejet sporadike dhe në baza ad-hok. Përqendrimi i këtyre përgjigjeve ka qenë i kufizuar kryesisht në debatet në takimet për Kosovën të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, në të cilat autoritetet kosovare marrin pjesë si mysafire, dhe ku vendi rëndom

¹⁴ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës, shkurt 2021.

¹⁵ Intervistë personale me Ardian Arifajn, ish-këshilltar politik i Presidentit të Kosovës, 19 shkurt, 2021.

¹⁶ Ibid.

përfaqësohet nga Ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara, si dhe me pjesëmarrjen e herëpashershme të Ministrit të Jashtëm, të Kryeministrit dhe të Presidentit të vendit. Në uebsajtet e Presidentit të Kosovës,¹⁷ të Kryeministrit,¹⁸ dhe të Ministrisë së Jashtme, është vështirë të gjendet ndonjë postim që ka të bëjë drejtpërdrejtë me operacionet malinje informative ruse ndaj Kosovës, me përjashtim të postit të Ministrisë së Jashtme të Kosovës të 26 shkurtit 2021.¹⁹ Në kuadër të këtij sfondi, zyrtari i lartë nga Zyra e Kryeministrit përfundon se është naivitet të besohet se përgjigja ndaj veprimeve destabilizuese ruse/serbe kundër Kosovës do të parandalohet nga bashkësia ndërkombëtare, për aq sa Kosova të mos bëjë investime sistematike lidhur me këtë.²⁰

Këto dëshmi të hulumtimit tregojnë qartë se edhe përkundrejt vetëdijes për rrezikun të cilin e parashtron Moska, autoritetet shtetërore të Kosovës deri më tash nuk e kanë ndërmarrë asnjë hap serioz për t'i adresuar në mënyrë sistematike operacionet informative malinje dhe luftën diplomatike ruse kundër vendit. Mungesa e përgjigjes strategjike të Kosovës ndaj këtyre përpjekjeve ruse për shkatërrimin e themeleve të shtetësisë së saj ka pasoja të dëmshme në integrimin e saj në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare. Dështimi i Kosovës për t'iu bashkangjitur UNESCO-s, Interpolit dhe Organizatës Botërore të Tregtisë, si dhe tërheqja e njohjeve nga më shumë se dhjetë vende, janë ndikuar po ashtu nga mungesa e politikës proaktive të Prishtinës ndaj Moskës. Për më tepër, Kosova nuk ka vendosur as strategji të politikës së jashtme, dhe as ndonjë drejtim strategjik për t'i trajtuar vështirësitë e kohës me të cilat vendi përballët në rrethanat e reja të politikës ndërkombëtare të shënuara nga ringjallja e Luftës së Ftohtë 2.0 midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë e Kinës, nga njëra anë, dhe tendosjeve e përçarjeve trans-atlantike në shtetësinë e Kosovës, nga tjetra. Në këto rrethana, ndërkohë që Serbia e ka një aleat të fuqishëm – Rusinë, e cila është armik i fuqishëm i Kosovës dhe i Perëndimit, asnjë nga miqtë e fuqishëm Perëndimorë të Kosovës nuk është armik i Serbisë, lufta diplomatike e të cilës kundër Kosovës kryhet në një lidhje të plotë me Kremlinin. Këto rrethana

¹⁷ <https://president-ksgov.net/en/search-results/?search=Russia>

¹⁸ <https://kryeministri-ks.net/en/page/2/?s=Russia>

¹⁹ https://www.mfa-ks.net/en/single_lajmi/4313

²⁰ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës, shkurt 2021.

kërkojnë ndërmarrjen e hapave të drejtpërdrejtë nga Qeveria e Kosovës në fuqizimin e aftësive të veta të marrëdhënies të jashtme për t'u marrë me këto sfida bashkëkohore.

Kapacitetet e Institucioneve të Politikës së Jashtme të Qeverisë së Kosovës

Kushtetuta dhe korniza ligjore e Kosovës i cakton Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kompetenca të veçanta për formulimin, zbatimin dhe udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit.

Lidhur me këtë, Kushtetuta e Kosovës, ndër të tjera, Presidentit të vendit ia ngarkon kompetencat e përfaqësimit dhe udhëheqjes së politikës së jashtme të vendit.²¹ Zyra e Presidentit të Kosovës përbëhet nga Kabineti i Presidentit (Shefi i Stafit, Këshilltarët Politikë, stafi përkrahës) dhe stafi civil që udhëhiqet nga Sekretari i Zyres së Presidentit.²² Zyra e Presidentit të Kosovës i ka 79 të punësuar.²³

Sidoqoftë, sipas Arifajt, Zyra e Presidentit e ka patur të paktën një këshilltar politik që e ka përcjellur informatën për operacionet informative malinje dhe që i ka rekomanduar përgjigjet përkatëse. Lidhur me këtë, Zyra e Presidentit e ka shfrytëzuar “armën” e vet kryesore, domethënë mundësinë për ta adresuar opinionin publik dhe për të folur në forumet ndërkombëtare me qëllim që ta ngrisë alarmin për kërcënimet ruse ndaj Kosovës dhe rajonit, dhe për përpjekjet e Perëndimit në ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë dhe në rajon.²⁴

Nga ana tjetër, Kushtetuta e Kosovës ia jep Qeverisë së Kosovës kompetencat për propozimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të vendit,²⁵ dhe Kryeministrit kompetencat për udhëheqjen e Qeverisë²⁶ dhe për konsultimin me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme dhe për çështjet e inteligjencës.²⁷ Zyra e Kryeministrit, pa llogaritjen e agjencive qeveritare që

²¹ Neni 84 (1) dhe 84 (10) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

²² Neni 14-17 i Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, që është nxjerrë në janar 2009, https://president-ks.gov.net/repository/docs/LAW_No_03L_094_ON_THE_PRESIDENT_OF_THE_REPUBLIC_OF_KOSOVO.pdf

²³ Ligji Nr. 07/L-041 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 1, 6 janar 2021, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F14DA73-6925-49B6-883E-014550C6E3C8.pdf>

²⁴ Arifaj.

²⁵ Neni 93 (1), Neni 84 (1) dhe 84 (10) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

²⁶ Ibid., Neni 94 (1) dhe 94 (5).

²⁷ Ibid., Neni 94 (7) dhe (9).

funksionojnë nën përkujdesin e saj, i ka 112 të punësuar, përfshirë stafin civil të udhëhequr nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyres së Kryeministrit dhe të emëruarit politikë.²⁸ Për më tepër, në kuadër të Kryeministrisë, Zyra e Komunikimit Publik që përbëhet nga gjashtë të punësuar, ka funksione dhe përgjegjësi të veçanta, përfshirë edhe atë që të kërkojë informata në bazë javore nga Zyrat e Komunikimit Publik të Ministrive lidhur me politikat dhe aktivitetet e tjera të Ministrive, dhe të dorëzimit të raporteve të rregullta nga mediat ndërkombëtare për Kryeministrin, Zëdhënësin e Qeverisë dhe Ministrive.²⁹ Mirëpo, sipas zyrtarit të lartë të Kabinetit të Kryeministrit, brenda Zyres së Kryeministrit, apo në çfarëdo niveli të Qeverisë së Kosovës, nuk është ndonjë grup apo zyrtar i veçantë që merret vetëm me Rusinë.³⁰

Korniza ligjore e Kosovës Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ia cakton kompetencën fundamentale të formulimit dhe zbatimit të politikës së jashtme të vendit,³¹ duke i raportuar Presidentit dhe Qeverisë së Kosovës, dhe duke u koordinuar me Presidentin dhe Kryeministrin lidhur me drejtimin strategjik dhe çështjet më të rëndësishme të politikës së jashtme të Kosovës.³² Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, përfshirë edhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, i ka 389 të punësuar,³³ përfshirë edhe 33 ambasada dhe misione diplomatike.³⁴ Nga këndvështrimi i organizimit, Departamenti i Marrëdhënieve Bilaterale i Ministrisë është përgjegjës për mbulimin e Ruisë. Mandat i këtij departamenti është që t'i mbulojë marrëdhëniet bilaterale të të gjitha kontinenteve të globit me përjashtim të Evropës, domethënë, SHBA-të e Kanadanë, Azinë dhe Paqësorin, Afrikën dhe Amerikat, Rusinë dhe Euroazinë, dhe Lindjen e Mesme e Vendet Arabe.³⁵ Ky departament, ndër të tjera, e ka për qëllim që për vendet e veçanta

²⁸ Ligji Nr. 07/L-041 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 1, 6 janar 2021, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F14DA73-6925-49B6-883E-014550C6E3C8.pdf>

²⁹ Zyra e Kryeministrit, Zyra për Komunikim Publik, 1.2, 1.11 dhe 3, <https://kryeministri-ks.net/en/the-prime-minister-office/offices/office-of-public-communication-opc/>

³⁰ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës.

³¹ Neni 3.2, Ligji 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

³² Ibid, 3.2 (h).

³³ Ligji Nr. 07/L-041 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 1, 6 janar 2021. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F14DA73-6925-49B6-883E-014550C6E3C8.pdf>

³⁴ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ambasadat e Republikës së Kosovës, <https://www.mfa-ks.net/misionet/493/ambasadat-e-republiks-s-kosovs/493>

³⁵ Departamenti i Marrëdhënieve Bilaterale, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, <https://www.mfa-ks.net/en/ministria/532/departamenti-pr-marrdhnie-dypalshe/532>

të këtyre zonave gjeografike t'i hartojë politikat si dhe analizat lidhur me marrëdhëniet bilaterale, si dhe që ta përgatisë bashkëpunimin me Presidencën, Zyren e Kryeministrit dhe me ministritë përkatëse për marrëdhëniet bilaterale me këto shtete. Sidoqoftë, brenda Ministrisë nuk është as edhe një zyrtar i cili flet rusisht, apo i cili e mbulon Rusinë në mënyrë sistematike dhe në baza ditore.³⁶ Pos kësaj, MPJD e Kosovës nuk e ka as ekspertizën më bazike për Rusinë.³⁷

Duke i pasur parasysh këto dëshmi, është evidente që organizimi i MPJD, trajnimi dhe caktimi i personelit të saj, janë në një shpërputhje shumë të madhe me kërkesat e nevojave të politikës së jashtme të Kosovës dhe qëllimeve të saj, dhe posaçërisht lidhur me luftën diplomatike dhe operacionet malinje informative të Rusisë kundër Kosovës. Pos organizimit të MPJD që është i papërshtatshëm për trajtimin e kërcënimit të Rusisë, Ministria nuk e ka hartuar ndonjë strategji të politikës së jashtme që do t'ia jipte një drejtim strategjik institucioneve të Kosovës dhe shërbimit të saj diplomatik.

Në këtë sfond, Zëvendës Ministresha e Jashtme Sahatqija vë në dukje që MPJD është një institucion i rëndësishëm diplomatik i cili duhet të merret në mënyrë të rregullt dhe sistematike me luftën diplomatike ruse që Kosovën e dëmton plotësisht në arenën ndërkombëtare. Reaksionet ad-hoc dhe të pakoordinuara në mediat sociale të zyrtarëve kosovarë janë larg nga ajo që të jenë të mjaftueshme për t'iu kundërvënë operacioneve informative malinje ruse kundër Kosovës. Ajo argumenton se pos ndërtimit institucional të kapaciteteve dhe përpjekjeve të koordinuara me aleatët e saj për t'iu kundërvënë kërcënimit rus, Qeveria e Kosovës duhet të investojë në diplomacinë digjitale dhe në përmirësimin e imazhit të vendit jashtë, në bashkëpunim me shoqërinë civile, mediat dhe bizneset.³⁸

Këshilltari Politik i ish-Presidentit, Ardian Arifaj, argumenton që fushata ruse mund të "luftohet" vetëm në bashkëpunim dhe në koordinim të të gjitha institucioneve të Kosovës, d.m.th., në koordinimin e institucioneve të qeverisë civile, të mekanizmave të sigurisë, dhe të OJQ-ve të specializuara në çështjet e sigurisë, dhe me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës,

³⁶ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës. Shkurt 2021.

³⁷ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, Shkurt 2021.

³⁸ Sahatqija.

interesat e të cilëve janë të kërcënuara nga qëndrimet anti-perëndimore ruse dhe nga ndikimi i saj në rajon. Ai e vë në dukje se institucionet politike duhet të bashkëpunojnë me mekanizmat e sigurisë dhe partnerët ndërkombëtarë për t'i përgatitur strategjitë kombëtare përkatëse të politikës së jashtme dhe të sigurisë për t'u marrë me kërcënimin rus për Kosovën dhe përtej saj. Lidhur me këtë, ai pohon se, pos diplomacisë, një nga fushëbetejat më të rëndësishme të Kosovës në marrjen me Rusinë, është në opinionet publike vendëse dhe të jashtme, dhe propozon që shoqëria civile dhe mediat duhet të përfshihen në fushatat e edukimit dhe të informimit, me qëllim që të fuqizohet qëndrueshmëria institucionale dhe shoqërore. Për më tepër, ai mendon se ndarja e fondeve për fushatat jashtë Kosovës është një hap tjetër që duhet të ndërmerret në kundërvënien ndaj operacioneve informative malinje ruse kundër Kosovës. Edhe pse këto fushata të informimit, të promovimit dhe të lobimit, janë të kushtueshme, sipas tij, çmimi që Kosova do ta paguaj do të jetë shumë më i lartë nëse ajo nuk i kundërvihet në mënyrë sistematike këtyre operacioneve ruse.³⁹

Së fundi, një zyrtar i lartë nga Kabineti i Kryeministrit vëren se, çuditërisht, institucionet e Kosovës nuk i kanë themeluar mekanizmat institucionalë për mbikëqyrjen e zhvillimeve në Rusi dhe në Serbi, dhe për kundërshtimin e veprimeve të tyre destabilizuese. Ai e vë në dukje se në vazhdimin e përpjekjeve të Kosovës për integrimet Euro-Atlantike, e të cilat po ashtu pengohen nga ndikimi rus, duhet të bëhen investime për themelimin e strukturave përkatëse hulumtuese si dhe për kundërshtimin e veprimeve destabilizuese, si në vend, ashtu edhe jashtë.⁴⁰

³⁹ Arifaj.

⁴⁰ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të Kabinetit të Kryeministrit të Kosovës. Shkurt 2021.

Kapacitetet e institucioneve të tjera relevante qeveritare

Fushëveprimi i gjerë i narrativave anti-kosovare dhe anti-perëndimore që ndiqen nga mekanizmat e politikës së jashtme ruse dhe nga mediat e kontrolluara nga ajo, kërkon një qasje të koordinuar në përgjigjen ndaj këtyre tipareve të operacioneve dezinformuese të Moskës kundër vendit. Për të ndërtuar kundër-narrativa sistematike dhe të besueshme kundër operacioneve informative malinje ruse, është nevojë që, para së gjithash, dhe mbi të gjithat, të ndërtohet një sistem i informimit në të tërë Qeverinë e Kosovës, i cili deri më tash nuk ka ekzistuar.

Lidhur me këtë, pos Zyres së Presidentit, Zyres së Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke i pasur parasysh fushëveprimin dhe grumbujt e narrativave dezinformuese ruse kundër Kosovës, është e një rëndësie parësore që të ketë një përfshirje të përhershme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Administrimit Publik, për t'i ofruar të dhënat për shkallët e krimit në vend, posaçërisht të atyre që kanë të bëjnë me komunitetin serb, me Kishën Ortodokse, dhe me ekstremizmin fetar, pastaj, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për të dhënat që kanë të bëjnë me krimet e luftës, të Ministrisë së Mbrojtjes për të dhënat që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për bashkëpunimin mbrojtës ndërkombëtar, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për të dhënat lidhur me vendet e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, ndërkohë që ministritë e tjera sipas nevojës mund të përfshihen herë pas here.

Nga këndvështrimi i aftësive institucionale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Administratës Publike është e pajisur mirë për ofrimin e të dhënave që nevojiten për t'iu kundërvënë luftës informative ruse kundër Kosovës. Lidhur me këtë, brenda Departamentit të Sigurisë Publike është i ngritur Divizioni për Hulumtim dhe Statistika (DHS), i cili, ndër të tjera, e ka për detyrë të bëjë hulumtime, analiza statistikore dhe grumbullim të informatave në terren për sigurinë e

përgjithshme, dhe për të ofruar draft-analiza dhe raporte statistikore në baza ditore, javore, mujore, gjysmë-vjetore dhe vjetore, për incidentet/krimet dhe për sigurinë publike.⁴¹

Nga ana tjetër, brenda Ministrisë së Drejtësisë, kohëve të fundit është themeluar Departamenti për Drejtësinë Tranzicionale dhe për përkrahjen e viktimave të krimit. Ky departament, ndër të tjera, e ka për detyrë që ta përkrahë mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës të kryera në Kosovë deri në 10 qershor 1999, dhe për themelimin dhe mbajtjen e bazave të shënimeve për dokumentimin e krimeve të luftës dhe për dëmet e luftës.⁴² Për më tepër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta luajë një rol thelbësor në këtë ndërmarrje, për shkak të faktit që ai posedon të dhënat gjithëpërfshirëse për rastet që janë gjykuar brenda sistemit të drejtësisë në Kosovë.⁴³ Nëse i jepet një format i duhur, duke përfshirë po ashtu edhe rastet e gjykimeve të krimeve të luftës, këto të dhëna mund të shndërrohen në një vegël të rëndësishme në kundërvënien narrativave ruse kundër Kosovës.

Në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes janë të vendosur dy departamente që janë të një rëndësie thelbësore për t'u marrë me kërcënimin rus, dhe atë Drejtoria për Politikën Mbrojtëse dhe Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri. Departamenti për Politika dhe për Strategji, dhe Seksioni i tij për Zhvillim dhe Analiza, që janë pjesë të Drejtorisë për Politikën Mbrojtëse, ndër të tjera, është përgjegjës për kryerjen e analizave dhe për bërjen e vlerësimeve të trendeve rajonale në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë,⁴⁴ e të cilat për rastin e trendeve të Serbisë dhe të bashkëpunimit të saj të mbrojtjes me Rusinë, janë të domosdoshme. Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri dhe Departamenti i saj për Koleksion dhe Analiza, ndër të tjera e kanë për detyrë që të "grumbullojnë, përpunojnë, vlerësojnë, analizojnë dhe shpërndajnë të dhëna dhe informata si dhe të paraqesin produkte të inteligjencës që kanë të bëjnë me grupe dhe organizata me veprimtari kërcënuese

⁴¹ Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Administratës Publike e Kosovës, Divizioni për Hulumtim dhe Statistika (DHS), <https://mpb.rks-gov.net/f/77/Division-for-Research-and-Statistics>

⁴² Departamenti për Drejtësinë Tranzicionale dhe për Përkrahjen e Viktimave të Krimeve, Ministria e Drejtësisë e Kosovës, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,162>

⁴³ Shih për shembull: Statistikat nga Raporti i Përgjithshëm Vjetor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, <https://www.gjyqesori-rks.org/statistics/?lang=en>

⁴⁴ Neni 10 (1.1), Rregullorja (GRK) NR. 07/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Caktimin e Pozitave të Punës në Ministrinë e Mbrojtjes 2, 26 prill 2019, https://mod.rks-gov.net/repository/docs/RREGULLOREQRK_NR_072019_P_R_ORGANIZIMIN_DHE_SISTEMATIZIMIN_E_VENDEV_E_T_PUN_S_N_MINISTRIN_E_MBROJTJES nga ZKM.pdf

të vendeve të huaja, [...], që mund ta kërcënojnë apo rrezikojnë veprimtarinë e MM dhe të FSK-së për sigurinë e vendit, mbrojtjen e integritetit, të integritetit territorial dhe të rendit kushtetues,”⁴⁵ dhe “bazuar në tregues paralajmërues, bën parashikime afatgjata të rreziqeve dhe të kërcënimeve potenciale për MM/FSK-në dhe për Republikën e Kosovës.”⁴⁶

Një numër i produkteve që këto dy Drejtori të Ministrisë së Mbrojtjes mund t’i ofrojnë, nëse jepen në formën e duhur, mund të kenë një rëndësi kyçe, jo vetëm në kundërvënien në mënyrë reaktive apo proaktive, por po ashtu edhe për parashikimin e operacioneve të veçanta informative malinje ruse kundër Kosovës.

Së fundi, brenda Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, funksionon Departamenti i Trashëgimisë Kulturore,⁴⁷ i cili pos që është përgjegjës për të tërë trashëgiminë kulturore në Kosovë, duhet të merret edhe me zonat e veçanta të mbrojtura të ndërlidhura me trashëgiminë e Kishës Ortodoske Serbe,⁴⁸ e të cilat janë elemente të rëndësishme të narrativave malinje ruse kundër Kosovës.

Duke patur parasysh dëshmitë e dhëna më sipër, mund të përfundohet se Kosova i ka kapacitetet themelore institucionale për t’u marrë me operacionet informative malinje ruse, mirëpo mangësitë kyçe lidhur me këtë çështje janë dobësitë e strukturave të politikës së jashtme të vendit, dhe posaçërisht të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, e cila deri më tash nuk i ka ndërtuar kapacitetet themelore për t’u marrë me Rusinë, si nga aspekti i diturive dhe strukturës institucionale, ashtu edhe në mungesën totale të koordinimit ndër-institucional qeveritar.

⁴⁵ Ibid, Neni. 47 (2.10).

⁴⁶ Ibid, Neni. 47 (2.6).

⁴⁷ Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës, <https://www.mkrs-ks.org/?page=2,10>

⁴⁸ Ligji Nr. 03/L-039, Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>, 20 shkurt 2008.

Kundërvënia Operacioneve Informative Malinje Ruse: Rruga Përpara

Rrethanat e tashme lidhur me operacionet informative malinje ruse kanë nevojë për një reagim të përnjëhershëm nga Qeveria e Kosovës, si në vendosjen e strukturave përkatëse, ashtu edhe në ndërtimin e kapaciteteve. Meqë themelimi i kësaj strukture duhet të fillojë nga e para, është nevoja që fillimisht të ndërtohet struktura bazike e cila brenda disa vitesh mund të evoluojë në një institucion të fuqishëm qeveritar që mund t'i kundërvihet në mënyrë efektive operacioneve malinje informative të Ruisë dhe të vendeve të tjera kundër Kosovës.

Me qëllim që t'i plotësojë nevojat e menjëhershme, Qeveria e Kosovës duhet ta themelojë një Task Forcë për Komunikim Strategjik, mandati kryesor i të cilës do të jetë t'i kundërvihet operacioneve malinje ruse dhe të vendeve të tjera kundër Kosovës, me një përqendrim të veçantë në organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshilli i Evropës, si dhe në misionet diplomatike të akredituara në Moskë dhe në Beograd, ku janë të vendosura qendrat e operacioneve informative malinje ruse kundër Kosovës. Detyrat thelbësore të kësaj task force duhet të jenë analizimi i operacioneve informative malinje ruse kundër Kosovës, përpilimi i kundër-narrativave proaktive për t'iu përgjigjur Moskës, si dhe parashikimi i narrativave dhe operacioneve të saj.

Një çështje e një rëndësie thelbësore në këtë drejtim është sigurimi i koordinimit të Zyres së Presidentit, Zyres së Kryeministrit dhe MPJD, në përgjigjen ndaj Ruisë. Me qëllim që të sigurohen përpjekjet e koordinuara të strukturave të politikës së jashtme të Kosovës lidhur me këtë çështje, struktura e vendim-marrjes politike të Task Forcës për Komunikim Strategjik mund të përbëhet nga përfaqësuesit e Zyres së Presidentit, Zyres së Kryeministrit dhe të Kabinetit të Ministrit të Jashtëm të Kosovës, i cili do të jetë i ngarkuar për t'i menduar vendimet përkatëse politike në përgjigjen ndaj luftës diplomatike ruse kundër Kosovës.

Nga ana tjetër, meqë mandati i Drejtorisë së Përgjithshme të Ministrisë së Jashtme, ndër të tjera është që të ofrojë këshilla në fushat e mbuluara nga departamentet e tij,⁴⁹ në këtë rast nga

⁴⁹ Drejtoria e Përgjithshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, <https://www.mfa-ks.net/en/ministria/528/drejtori-i-prgjiithshm/528>

Departamenti i Marrëdhënieve Bilaterale i cili e mbulon Rusinë,⁵⁰ Drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme të Kosovës mund ta luaj rolin e Sekretarit të kësaj Task Force. Roli kryesor i tij/saj duhet të jetë të ofrojë këshilla për përgjigjet e mundshme ndaj deklaratave të zyrtarëve rusë dhe të mediave në Kosovë, të cilat duhet të përcillen në baza ditore nga të paktën një zyrtar përgjegjës me njohuri të duhur për Rusinë në Departamentin për Marrëdhëniet Bilaterale, i cili duhet të caktohet sa më shpejtë që të jetë e mundshme nga Ministria. Roli i Drejtorit të Përgjithshëm duhet t'i përfshijë po ashtu edhe detyrat e dhënies së këshillave për kundërnarrativat apo narrativat proaktive kundër operacioneve informative malinje ruse.

Në këtë sfond, Task Forca është e domosdoshme për të ndërtuar një ndërlidhje të përhershme me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të Administratës Publike (Departamenti i Sigurisë Publike dhe Divizioni i tij për Hulumtime dhe Statistika), me Ministrinë e Drejtësisë (Departamenti për Drejtësinë Tranzicionale), Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Mbrojtjes (Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes dhe Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri) dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Departamenti i Trashëgimisë Kulturore).

Këta trupa duhet të ofrojnë asistencë për Task Forcën me qëllim që të sigurojnë reagime me kohë dhe të kualifikuara ndaj operacioneve informative malinje ruse dhe narrativave kundër Kosovës. Detyra e tyre kryesore duhet të jetë të ofrojnë informata për Sekretarin e Task Forcës, qoftë me kërkesë, qoftë në mënyrë proaktive. Për çështjet e veçanta që nuk mund të mbulohen nga këto institucione, kur të jetë e domosdoshme, Sekretari i Task Forcës duhet të ketë ndërlidhje me institucionet tjera përkatëse qeveritare të Kosovës, ashtu që të kemi një informatë të kualifikuar dhe me kohë.

⁵⁰ Departamenti i Marrëdhënieve Bilaterale, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.




Fig.1. Struktura e Rekomanduar e Task Forcës për Komunikim Strategjik

Struktura e propozuar, si e tillë, nuk do të jetë e mjaftueshme për adresimin e operacioneve informative malinje ruse që përhapen nga mediat e kontrolluara nga Moska. Para së gjithash dhe mbi të gjithat, me qëllim që të jetë në gjendje të japë rezultate të kualifikuara dhe me kohë, brenda kësaj strukture duhet të rrënjoset një njohuri e thellë për metodat e strategjive dhe të taktikave dezinformuese ruse, dhe duhen fituar shkathtësitë për t'iu kundërvënë dezinformimit dhe narrativave të ndjekura nga Moska.

Së dyti, posedimi i diturive të avancuara për historinë politike, ushtarake dhe diplomatike të Ruisë, me një përqendrim të veçantë në epokën e Putinit, si dhe për ekonominë e saj, është i domosdoshëm për t'u marrë me Moskën në mënyrë profesionale. Lidhur me këtë, strukturave të politikës së jashtme të Kosovës u mungojnë njohuritë themelore për këto tema, dhe nuk është bërë as edhe investimi më i vogël nga Qeveria e Kosovës për t'i ndërtuar këto kapacitete.⁵¹

⁵¹ Bisedë personale me një zyrtar të lartë në Ministrinë e Jashtme të Kosovës, shkurt 2020.

Rekomandime:

Duke i patur parasysh gjetjet e këtij raporti të politikave për kapacitetet institucionale dhe koordinimin ndër-institucional të Qeverisë së Kosovës, KIPRED-i propozon rekomandimet vijuese për tejkalimin e mangësive të thella të Kosovës për t'i ekspozuar dhe për t'iu kundërvënë operacioneve malinje informative dhe diplomatike ruse ndaj Kosovës:

- Qeveria e Kosovës duhet:
 - Ta merr sa më shpejtë që të jetë e mundur vendimin për themelimin e Task Forcës për Komunikim Strategjik për t'u marrë me operacionet malinje të Rusisë dhe të vendeve të tjera që e shënjestrojnë Kosovën.
 - Ta përpilojë një Strategji të re të Politikës së Jashtme që do t'i përshtatet politikës ndërkombëtare bashkëkohore, përfshirë ndikimin malinj rus në Kosovën.
 - Ta përpilojë Planin e Veprimit për t'iu kundërvënë luftës diplomatike ruse kundër Kosovës dhe operacioneve të saj informative malinje që janë duke u përhapur nga mediat e kontrolluara nga Moska.
 - T'i mbledhë dhe të ndajë fonde për nevojat për ndërtimin e kapaciteteve të Kosovës për t'iu kundërvënë luftës diplomatike dhe operacioneve informative malinje ruse kundër Kosovës.
 - Të ndajë fonde për promovimin dhe lobimin e Kosovës jashtë.

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës duhet:
 - Ta emërojë të paktën një zyrtar përgjegjës për Rusinë në Departamentin për Marrëdhëniet Bilaterale.
 - Të organizojë kurse të gjuhës ruse për nevojat e Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, dhe për institucionet dhe agjencitë e tjera qeveritare.

- Të organizojë kurse për metodat e strategjive dhe të taktikave dezinformuese ruse dhe për kundërvënien ndaj dezinformatave dhe narrativave për personelin e Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, të institucioneve dhe agjencive të tjera qeveritare, si dhe për think tanket e mediat.
- Të organizojë kurse për historinë politike, ushtarake dhe diplomatike të Ruisë për personelin e Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, dhe për institucionet e agjencitë e tjera qeveritare, si dhe për think tanket e mediat.